



## Thirrje për punime

### Konferenca V e Muzeut të Bankës së Shqipërisë

"Bankat qendrore dhe historia ekonomike: Reflektime dhe perspektiva"

Tiranë, 11 qershor 2025

Viti 2025 shënon 100-vjetorin e themelimit të Bankës Kombëtare të Shqipërisë. Për të përkujtuar këtë ngjarje, Muzeu i Bankës së Shqipërisë organizon konferencën V të tij, me temë "Bankat Qendrore dhe historia ekonomike: Reflektime dhe perspektiva". Konferenca do të mbahet në ambientet e Bankës së Shqipërisë, në Tiranë, më 11 qershor 2025.

Organizatorët mirëpresin punime teorike dhe empirike që përdorin të dhëna historike për të na ndihmuar të njohim më mirë zhvillimet monetare, financiare dhe ekonomike të së shkuarës dhe të tashmes. Gjithashtu, mirëpresim kërkime ekonomike, monetare, financiare dhe të historisë bankare, si dhe studime mbi historinë e mendimit ekonomik. Punimet mund të kenë qasje kuantitative ose narrative, por mund të bazohen edhe në dokumente arkivore. Do të merren në konsideratë si punimet e përfunduara ashtu edhe draftet paraprake.

Profesor Kevin Hoover (Historian i ekonomisë, Universiteti Duke) do të jetë i ftuar nderi.

Temat me interes përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- Origjina e sistemeve bankare në Ballkan dhe ndikimi i Perandorisë Osmane gjatë shekullit të 19-të dhe fillimit të shekullit të 20-të.
- Roli i ngjarjeve gjeopolitike, institucioneve ndërkombëtare dhe ndikimi i traktateve dhe aleancave të pas Luftës së Parë Botërore dhe Luftës së Dytë Botërore në sistemet ekonomike dhe financiare në Shqipëri e Ballkan gjatë fillimit të shekullit të 20-të.
- Regjimet monetare dhe të kursit të këmbimit, bankat qendrore dhe çmimet në ekonomitë socialiste të planifikuara, ndërveprimi i tyre me politikën ekonomike.
- Historia monetare dhe financiare e Shqipërisë, Ballkanit dhe Evropës, gjatë shekullit të kaluar, duke përfshirë ndikimin e krizave financiare dhe ekonomike në bankat qendrore, objektivat e tyre dhe kuadrin rregullator.
- Qarkullimi i ideve dhe praktikave ndërkombëtare, figurat dhe personalitetet kryesore, misionet teknike ndërkombëtare në formësimin e bankave dhe bankut qendror në Shqipëri, Ballkan dhe bllokun socialist në shekujt 19 dhe 20.



### **Data të rëndësishme**

Afati i dorëzimit të abstrakteve: 15 nëntor 2024  
Njoftimi i pranimit: 16 dhjetor 2024  
Afati për dorëzimin e punimit të plotë: 30 prill 2025  
Data e Konferencës: 11 qershor 2025

### **Udhëzime**

Autorët inkurajohen të dërgojnë abstrakte prej jo më shumë se 300 fjalësh dhe një jetëshkrim të shkurtër në adresën: [muzeu@bankofalbania.org](mailto:muzeu@bankofalbania.org).

Punimet e plota duhet të jenë nga 5000 deri në 8000 fjalë.

Ftojmë autorët e interesuar të marrin pjesë me punimet e tyre origjinale, aktualisht në shqyrtim ose të publikuara së fundmi, të cilat synojnë të integrojnë temat e përmendura më sipër në studimin e historisë ekonomike. Punimet e propozuara mbi të gjitha fushat e kërkimit ekonomik janë të mirëpritura. Inkurajojmë pjesëmarrjen e studentëve që ndjekin ciklin master apo të sapodiplomuar.

Programi dhe informacione të tjera rreth konferencës do të publikohen në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë ([www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org)). Pyetjet rreth konferencës mund të drejtohen në adresën: [muzeu@bankofalbania.org](mailto:muzeu@bankofalbania.org).

Mbetemi në pritje të kontributit tuaj, i cili do të pasurojë dhe do të sjellë një vlerë të shtuar për punimet e konferencës.